

Njoftimi Paraprak i Fituesit

DATA E TRANSMETIMIT: Ky Njoftim dërgohet me *email* më 30 Janar 2026.

Korporata:	Korporata e Investimeve Shqiptare
Projekti i Investimit:	Korpusi i Inspektorateve dhe Shtëpia e re e fëmijëve “Zyber Hallulli”
Konkursi i projektimit:	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Korporata e Investimeve Shqiptare
Titulli i Kontratës:	Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i objektit multi-funksional në Rugën e Elbasanit, Tiranë

Ky Njoftim Paraprak i Fituesit (Njoftim) ju njofton për vendimin tonë për të lidhur kontratën e mësipërme. Transmetimi i këtij Njoftimi fillon periudhën e ankimimit. Gjatë periudhës së ankimimit ju mund të:

- a) kërkon një informim në lidhje me vlerësimin e propozimit tuaj dhe/ose
- b) të paraqesni një ankesë në lidhje me vendimin për lidhjen e kontratës.

1. Propozuesi i suksesshëm:

Emri:	Shoqëria “MOTUS” shpk, me nënkontraktor të specializuar “Asab” shpk + Son Engineering & Construction + Rojkind Arquitectos S.C + Julian Kasharaj
Adresë:	Sheshi Italia, Arena Center, Kati 5, Seksioni D, Tirana, Albania Email: e.spahiu@mutos.al
Përqindja e sipërfaqjes së ofruar për Korporatën, e përllogatitur mbi sipërfaqjen totale të metrave katrorë të objektit multifunksional të zhvilluar në pronën e Korporatës në Rrugën e Elbasanit, Tiranë (mbitokë dhe nëntokë), është:	46 % (dyzet e gjashtë përqind)

2. Renditja e rishikuar e propozueve të “Listës 4” është si më poshtë:

Nr.	Aplikuesit	Përqindja e sipërfaqjes së ofruar për Korporatën, e përllogatitur mbi sipërfaqjen totale të metrave katrorë të objektit multifunksional të zhvilluar në pronën e Korporatës në Rrugën e Elbasanit, Tiranë (mbitokë dhe nëntokë), është	Renditja (duke marrë në konsideratë dhe vendimin e Jurisë Ndërkombëtare)
1	Shoqëria “MOTUS” shpk, me nënkontraktor të specializuar “Asab” shpk + Son Engineering & Construction + Rojkind Arquitectos S.C + Julian Kasharaj	46 %	Në vend të parë
2	Shoqëria “PROGEEN l.l.c” me nënkontraktor të specializuar Taller Hector Barroso + Studio	45.5 %	Në vend të dytë

	B&L l.l.c + Dorian Blea + Agim Seranaj + Ardian Paci		
3	Bashkimi i Subjekteve “BE-IS”shpk & “Cebra Arkitekter A/S” me nënkontraktor të specializuar LOFT Architects dhe Superflex Studio	45 %	Në vend të tretë

3. Arsyeja/at pse propozimi juaj ishte i pasuksesshëm – Nuk aplikohet

4. Si të bëni një ankesë

AFATI: Afati i fundit për dorëzimin e një ankesë lidhur me konkurimin që kundërshton vendimin për lidhjen e kontratës skadon në mesnatë, 6 Shkurt 2026 (ora lokale).

Jepni emrin e kontratës, emrin e Propozuesit, detajet e kontaktit; dhe adresoni ankesën lidhur me konkurimin si më poshtë:

Kujdes: Njësia e Trajtimit të Ankesave

Korporata: Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa e emailit: competiton@aicorporation.al

Në këtë pikë të procesit të konkurimit, ju mund të paraqisni një ankesë lidhur me konkurimin duke kundërshtuar vendimin për lidhjen e kontratës. Ju nuk keni nevojë të keni kërkuar ose marrë një informim para se të bëni këtë ankesë. Ankesa juaj duhet të dorëzohet dhe të merret nga ne përpara përfundimit të periudhës së ankimit.

Informacione të mëtejshme:

Për më shumë informacion, shihni rregulloren përkatëse të procedurave konkurruese të Korporatës. Ju duhet t'i lexoni këto dispozita përpara se të përgatitni dhe paraqisni ankesën tuaj.

Në përmbledhje, ekzistojnë katër kërkesa thelbësore:

1. Ju duhet të jeni një 'palë e interesuar'. Në këtë rast, kjo do të thotë se ju jeni një Propozues i cili ka dorëzuar një propozim në këtë konkurim, dhe jeni marrësi i një Njoftimi paraprak për lidhjen e kontratës.
2. Ankesa mund të kundërshtojë vetëm vendimin për lidhjen e kontratës.
3. Ju duhet të paraqisni ankesën brenda afatit të lartpërmendur.
4. Ju duhet të përfshini, në ankesën tuaj, të gjithë informacionin e kërkuar nga rregulloren përkatëse të procedurave konkurruese të Korporatës.

5. Periudha e ankimimit

AFATI: Periudha e ankimimit do të përfundojë në mesnatën e 6 Shkurt 2026 (ora lokale).

Periudha e ankimimit zgjat **shtatë (7) ditë** pas datës së transmetimit të këtij Njoftimi paraprak për lidhjen e kontratës. Periudha e ankimimit mund të zgjatet. Nëse kjo ndodh, ne do t'ju njoftojmë për zgjatjen.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë Njoftim, ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni.